



Në bazë të nenit 103 të Ligjit mbi arsimin sipëror të RMV-së, Statutit të Universitetit të Tetovës, Rregullores për kriteret dhe kushtet e regjistrimit në studimet e ciklit të parë dhe Rregullores për sistemin e kredive dhe transferimit në njësitë akademike, Vendimit nga mbledhja e Këshillit të Rektoratit nr. 02-4409/1 dhe Konkursit për regjistrim të studentëve në vitin akademik 2021/22, Universiteti i Tetovës shpall:

N J O F T I M

për transferimin dhe regjistrimin e studentëve në fakultetet dhe njësitë akademike të Universitetit të Tetovës në semestrin veror 2021/22

I. Transferimi do të realizohet në programet aktive studimore të fakulteteve amë:

1	Fakulteti i Shkencave Matematike - Natyrore	7	Fakulteti Juridik
2	Fakulteti Filozofik	8	Fakulteti Ekonomik
3	Fakulteti Filologjik	9	Fakulteti i Teknologjisë Ushqimore dhe të Ushqyerit
4	Fakulteti i Arteve	10	Fakulteti i Bujqësisë dhe Bioteknologjisë
5	Fakulteti i Kulturës Fizike	11	Fakulteti i Administrimit të Biznesit - Kumanovë
6	Fakulteti i Shkencave të Zbatuara	12	Fakulteti Pedagogjik

II. Kushtet e transferimit të studentëve në UT:

A. Studenti me status të studentit të UT- së:

- Të drejtë transferimi brenda njësive akademike të UT-së kanë të gjithë studentët me status aktiv të **studimeve në semestrin dimëror 2021/22, të cilët kanë përfunduar së paku një vit akademik**;
- Pas realizimit të transferimit të ECTS kredive, studentit gjatë regjistrimit në programin e transferuar, është i obliguar t'i çregjistrojë studimet nga programi i cili transferohet, varësisht natyrës së programit studimor dhe mënyrës së studimeve (të rregullta);
- Transferimi i ECTS kredive mund të bëhet edhe në drejtimet brenda programit të njëjtë studimor dhe në mes planprogrameve të studimeve të ndryshme brenda të të njëjtit program. Diferencat dhe ngjashmëritë e lëndëve i përcakton Koordinatorin për ECTS i fakultetit përkatës dhe komisioni përkatës.]
- Studentët të cilët i ripërtrijnë studimet përmes transferimit brenda programit të njëjtë, nuk duhet të aplikojnë online, por vetëm parashtrojnë kërkesë për ripërtirjen e studimeve online në www.unite.edu.mk/registration.

B. Studentë nga universitetet tjera:

- Të drejtë transferimi nga institucionet tjera të arsimit sipëror nga vendi dhe jashtë, në njësitë akademike të UT-së, kanë të gjithë kandidatët me status aktiv të studentit në semestrin dimëror 2021/22 që kanë regjistruar dhe të përfunduar (dëgjuar) së paku një semestër nga universiteti prej ku vjen kandidati, ndërsa detyrimet tjera i kryejnë varësisht statusit të transferimit.
- Gjatë aplikimit, detyrimisht kandidati duhet të paraqes dëshmi për akreditimin e institucionit të arsimit të lartë, respektivisht fakultetit apo programit nga i cili transferohet ose dokumente shtesë varësisht kërkesës së komisionit për transfer (syllabuset etj).
- Dëshmi për nostrifikimin e shkollimit të mesëm dhe Vendim për ekuivalentimin e notave nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës e RMV-së (për shtetasit e huaj ose shkollim të mesëm jashtë vendit).
- Studenti mund të transferohet në fakultetin dhe programin e njëjtë studimor ose në drejtime të ngjashme me fakultetet dhe programet studimore të UT-së. Ngjashmërinë e programeve studimore e përcakton komisioni për transfer i fakultetit.

Ç. Kandidatët që transferohen, regjistrohen me koofinancim në studime, respektivisht sipas tarifave aktuale të studimit për programet studimore në vitin akademik 2021/22.

D. Në programet studimore, për të cilat në Konkursin për regjistrim janë përcaktuar provime pranuese (kontroll i talentit), kandidatët që aplikojnë për transferim të kredive, do të vlerësohen nga komisionet e fakulteteve.

E. Në rast se numri i kandidatëve është më i lartë se sa ka vende të lira në programin studimor, atëherë përparësi kanë kandidatët të cilët kanë arritur notë më të lartë mesatare.

H. Regjistrimi i lëndëve jo të transferuara bëhet në kontinuitet sipas realizimit të programit aktiv studimor dhe bëhet në bazë të parakushteve për dëgjim.

III. Afatet e paraqitjes për transferimin dhe regjistrim në semestrin veror 2021/22:

Paraqitja e kandidatëve (aplikimi në administratën e fakultetit)	25.01 - 04.02. 2022
--	---------------------

Sjellja e vendimeve preliminiare për pranim të kandidatëve (Kandidati vendimin preliminar e pranon në e-mail, me të cilin ka aplikuar)	08 - 11.02.2022
Sjellje e vendimeve përfundimtare	48 orë pas pranimit të versionit preliminar
Regjistrimi i kandidatëve të transferuar*	14 - 18.02.2022

***KANDITATËT TË CILËT NUK DO TA BËJNË REGJISTRIMIN E SEMESTRIT NË KOHËN E CAKTUAR, DO TA HUMBIN TË DREJTËN PËR TRANSFERIM TË ECTS KREDIVE**

IV. Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim:

- **APLIKIMI ONLINE (i obliguar) deri më 02.02.2022. Kandidatët duhet brenda në formular online, t'i plotësojnë edhe lëndët sipas certifikatës së notave, në : <http://www.unite.edu.mk/apply>**
 - **Gjatë aplikimit online kandidatët duhet dokumentet dhe fletëpagesat e skenuara ose si fotografi t'i bashkangjesin (attach) brenda formularit**
- **Certifikata origjinale e notave dhe Indexi** nga Universiteti amë (nëse ka dhënë provime dhe universiteti lëshon indeks);
- **Vërtetimi për statusin aktiv të studentit në vitin akademik 2021/22**
- **Dëshmi për akreditimin e njësisë akademike dhe (Vendim) vërtetim për ekuivalentimin e notave nga MASH i RMV-së (shtetasit e huaj);**
- **Dëftesat origjinale** nga shkollimi i mesëm (ose të verifikuara në noter) dhe **diplomën e shkollës** së mesme të kryer;
- **Certifikatën e lindjes** dhe dëshmi për **nënshtetësi** (certifikatë ose aktvendim);

Vërtetim për pagesën:

- a) **1050 denarëve** në xhirollogarinë e Universitetit: në emër të taksave administrative (**data e fletëpagesës detyrimisht të shënohet në formularin për aplikim online, pastaj origjinali dorëzohet te shërbimi studentor**).
- b) **600 denarëve** për provim pranues

Kandidatët të cilët janë të pranuar (pas shpalljes/dhënies së vendimit përfundimtar), në afatin e caktuar duhet të realizojnë regjistrimin e studimeve, në të kundërtën vendimi i transferimit do të shpallet i pavlefshëm. Gjatë regjistrimit duhet të dorëzojnë:

1. Fletëparaqitje për regjistrim (fletëparaqitjet merren në shërbimin për çështje studentore të fakultetit në të cilin studenti regjistrohet)
2. Aktvendim ose dëshmi për çregjistrimin e studimeve nga fakulteti i cili transferohet (varësisht mënyrës së studimeve);
2. Tri fotografi (dy fotografi 6 x 9 dhe një – 4 x 5 c. m.)
3. Vërtetim për pagesën e mjeteve:
 - a. **100 denarë** në xhirollogarinë 240190104749495 (banka e pranuesit: Uni Banka AD Skopje): në emër të Parlamentit Studentor në Universitetin e Tetovës (SHPSUSHT)
 - **1200 denarë**, në xhirollogarinë e Universitetit: në emër të dhënies së Index-it.
 - **750 denarë**, në xhirollogarinë e Universitetit: në emër të veprimtarive informative, sportive, kulturore të studentëve të Universitetit.
 - **6000 denarë**, në xhirollogarinë e Universitetit: në emër të shpenzimeve për realizimin e transferimit.
 - **Pagesën për semestër.**

Të gjitha pagesat e lartpërmendura do të kryhen në xhirollogarinë e Universitetit, në këtë mënyrë:

Pagesa prej Maqedonisë së Veriut

- Pagesat mund të bëhen edhe përmes aplikacioneve elektronike bankare me formular **PP50** ose me fletëpagesë në bankë/postë;
- Fletëpagesa qoftë përmes aplikacionit ose fletëpagesës në bankë, duhet të figurojë në **emër të studentit**;
 - ❖ Në emri i marrësit (**назив на примачот**) - Universiteti i Tetovës,
 - ❖ Në „banka e marrësit“ (**банка на примач**) – Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut,
 - ❖ Në „llogaria“ (**сметка**) – **10000000063095**,
 - ❖ Në „shuma“ (**износ**) – shuma e mjeteve financiare që duhet të paguhen,

- ❖ Në „Ilogaria e shfrytëzuesit buxhetor - subjekti shfrytëzues” (сметка на буџетски корисник – единка корисник“ – **1600160054 788 10**;
- ❖ në „shifra dhe programi i të hyrave” (приходна шифра и програма) – **723019 43**, ndërsa në „mënyra” (начин) – **2**;
- ❖ Në rubrikën qëllimi i realizimit të pagesës (цел на дознака) – qëllimi i pagesës (aplikim, semestri etj).
 - o Në rast se pagesat përmes aplikacioneve bankare i kryen person tjetër për studentin e caktuar, në këtë rubrikë ((цел на дознака) – qëllimi i pagesës)), e shënon edhe emrin e studentit për të cilin e kryen pagesën (shembull: aplikim-Emri Mbiemri)

<http://www.unite.edu.mk> ,Tetovë, Dhjetor, 2021